



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



DREJTORIA E KULTURËS
Sektori për Rini dhe Sport

THIRRJE PËR APLIKIM

Komuna e Prishtinës fton të gjitha OJQ-të të cilat implementojnë projekte rinore që të aplikojnë për financim. Projektet duhet të jenë në përputhje me politikat programore të Sektorit të Rinisë, të cilat janë :

- Promovimi i Vullnetarizmit
- Integrimi i grupeve rinore dhe atyre të marginalizuara
- Fuqizimi i Organizatave Rinore (seminare, trajnime, kurse për aftësimin e të rinjve etj)
- Edukimi jo-formal (stimulimi i të miturve për edukim dhe arsim)

KRITERET

1. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë implementuar projekte në të cilat kanë qenë të përfshirë moshat rinore;
2. Projekt propozimi duhet të jetë unik, d.m.th. nuk është implementuar në aktivitetet e mëparshme të këtij lloji;
3. Në kushte të barabarta, përparësi në përzgjedhje do të kenë projektet të cilat kanë për synim involvimin e të rinjve në viset rurale.
4. Përparësi në përzgjedhje do të kenë projektet që bazohen në shtyllat e politikave komunale për rini.

Në këtë konkurs mund të aplikojnë edhe një grup organizatash së bashku për implementimin e një projekti të caktuar.

Kërkesës duhet ti bashkëngjiten edhe dokumentet :

- Kopja e letërnjoftimit për parashtruesin e kërkesës
- Certifikata e numrit të regjistrimit të OJQ-ës;
- Certifikata e numrit fiskal të klubit/shoqatës;
- Letërnjoftimi i bartësit të xhirollogarisë;
- Vërtetimi / dëshmia e bankës të subjektit i cili aplikon
- Të dhënat e aplikuesit: telefoni , email adresa.

Projekt propozimet mund t'i dorëzoni nga data **30/01/2017** deri me datën **20/02/2017** në orën 15:00 në adresën: Komuna e Prishtinës (ndërtesa e vjetër), Zyra pritëse, Sporteli nr.5.

Formulari për aplikim mund të shkarkohet në vegzën: <http://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Departments/Kultures,Rinise,Sportit/Subvencionet/Subvencione-per-Rini-dhe-Sport/Formularet-per-aplikim.aspx>

VËREJTE: Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kërkesës dhe aplikuesit të cilët nuk kanë përmbyllur projektet nga edicionet e kaluara ndaj DK -së, nuk do të merren parasysh nga komisioni për shqyrtimin e kërkesave.

Komuna e Prishtinës
Adresa: Rr.U Ç K Nr. 2, Prishtinë
Telefon-Faks; 038/230900/ 1120
<http://www.kk.rks-gov.net/prishtinë>